

Prof. as. dr. Murat GECAJ

ÇETA E STUDENTËVE SHQIPTARË TË SELANIKUT

Në pranverën e vitit 1912, barbarizmat armike në Shqipërinë e veriut dhe në Kosovë, bënë të shpërthente kryengritja e përgjithshme mbarëpopullore. Rinia studentore, kudo që ishte, përfaqësonte flamurtaren e shqiptarizms. Selaniku njihej si qendër e rëndësishme, ku shqiptarët shkonin për arsimim të lartë, pasi ishte afër dhe shpenzimet ishin më të pakta për ta. Disa punonin e mësonin. Ndër ta, kishte studentë nga Korça, Gjirokastra, Vlora, Tirana, Durrësi, Dibra, Kosova etj. Me gjysmë opinge, si thotë shprehja, por i vijonin studimet me zell e ngulm, që të shkolloheshin për vete, por sidomos për atdheun.

Një ndër botimet me interes, që pasqyrojnë përpjekjet e pareshtura dhe vetëmohuese të popullit dhe sidomos të rinisë sonë, në luftën shumëvjeçare për lirinë e pavarësinë e atdheut, kundër sundimit shekullor otoman, është dhe libri i shkruar nga Lekë Zezaj. Ai mban titullin: "Çeta e studentëve shqiptarë të Selanikut", publikuar në Tiranë në vitin 1944, nga Shtypshkronja "Atdheu".

Ishte periudha, kur e gjithë Shqipëria ndodhej në një situatë "si kazan, që ziente". Që nga Preveza në Tivar, nga Shkupi në Adriatik, kudo ku flitej shqip, të gjithë ishin gati, me armët në dorë, kundër sundimit të Perandorisë Otomane. Shqiptarët kërkonin me ngulm e vendosmëri: "Liri dhe vetëqeverim!" Por jo me lutje e paqe, por me armët ngjeshur, se ishin lodhur pa masë në rrugën e parë. Prandaj Stambolli nisi një operacion të gjerë kundër shqiptarëve "të pabindur", i cili kryesohej nga gjenerali gjakatar Shefqet Turgut Pasha. Synimi i tij kryesor ishte që ta nënshtronte me çdo kusht mbarë Shqipërinë, sidomos Kosovën kryengritëse.

Xhonturqit i kishin harruar premtimet, gjoja, liberale dhe nuk e mbajtën fjalën e dhënë: Ta linin arsimin të lirë, në gjuhën amtare; të lejonin shtypjen e gazetave e të librave shqipe etj. Përkundrazi, ndaluan edhe përhapjen e atyre librave e gazetave, që botoheshin jashtë. Kundër xhonturqve u formua një parti tjetër politike, "Hurrijet ve Ittilaf", me nismën e Ali Beut, në Selanik. Ajo premtonte lirinë e gjuhës shqipe e të shkollave në gjuhën amtare. Këtë fakt e shfrytëzuan studentët shqiptarë të Selanikut. Sipas ligjit, u mblodhën 25 veta dhe formuan klubin shqiptar. Por ky veprim ra në sy të policisë dhe këta kërkuan prishjen e klubit.

Në qershor 1912, në Selanik ishte hapur dhe "Klubi i Bashkimit", ku mblidheshin shqiptarët e atij qyteti. Klubi kryesohej nga atdhetari i njohur nga Kosova, mësuesi i shqipes në Normalen e Shkupit dhe veterani i arsimit tonë kombëtar, Sali Gjuka-Dukagjini (tani "Mësues i Popullit"), më vonë delegat aktiv në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, që shpalli Pavarësinë. Klubi ishte i vogël, se i tillë ishte dhe numri i shqiptarëve aty. Vetëm studentët, nja 15 të tillë, formonin diçka më kompakte. Megjithatë, ky klub zhvilloi veprimtari të dukshme e frytdhënëse. Siç do të pohohej më vonë: "Sali Gjuka, kjo mendje e shqetësuar dhe ky idealist veprues nga të rrallët, i mblodhi studentët në grup veprues, jo vetëm për propagandë, po edhe sidomos për veprim". Ishte hedhur parulla luftarake: "Ja vdekje, ja liri!", pra nuk mjaftonte vetëm veprimtaria teorike. Mbarë Kosova ishte në këmbë, "në shtatë e në shtatëdhjetë", me pushkë në dorë në male e fusha, me këngë luftarake në gojë.

Pra dhe studentët nuk mund të rrinin të qetë, në këto kushte. U lëshua njëzëri thirrja prej tyre: "Duhet të dalim maleve, o shokë! Të shkojmë atje, ku luftojnë dhe vriten vëllezërit tanë. Në Kosovë, në kryengritje, të luftojmë me armë në dorë!" U vendos që ata ta linin shkollën përgjysmë, të vishnin opingat dhe të dilnin në male, me pushkët në krah. Por ata nuk kishin armë as para. Në këto kushte, kryetari i klubit, Sali Gjuka mendoi të gjente një rrugëzgjdhje, që autori i librit e vlerëson kështu: "Kjo mendje e shqetësuar dhe ky idealist, që s'e kishte shokun". Ndërsa më poshtë vijon: "Gjersa shokët po trishtoheshin, duke parë se ndodheshin përpara pengimesh të mëdha, shumë më të mëdha se fuqitë e tyre, Sali Gjuka po e forconte bindjen e tij se ndërmarrja do të dilte

me suksesin e shpresuar. Ai kish planin e tij, por kish sidomos vullnetin dhe besimin në çështje".

Në atë kohë Greqia e shihte me sy të mirë çdo rebelim kundër Turqisë. Këtë gjë e dinte mirë Sali Gjuka, prandaj vendosi të përfitonte nga situata aktuale. Dhe ashtu veproi. Pa i bërë zë askujt, as bashkëlufëtëtarëve të tij studentë, ai bisedoi me konsullin grek të Selanikut dhe i propozoi që të dërgonte aty një çetë, për në Shqipërinë e Veriut. Por duhej që qeveritarët grekë t'i furnizonin me armët e municionin e duhur. Në planin e tij, si pikë fillestare, Sali Gjuka kishte dërgimin e studentëve në Kosovë, ku zhvilloheshin luftimet e kryengritësve. Ishte marrë vesh edhe me Hasan Prishtinën, i cili drejtonte kryengritjen e përgjithshme antiosmane.

Pas disa ditësh, Sali Gjukën e thirri konsulli grek i Selanikut dhe i tregoi se do t'ia jepnin çetës armët e kërkuara, bashkë me municionin e nevojshëm, të cilat do t'ua dorëzonin në Athinë. Këtë plan ai e pranoi me kënaqësi. Krahas kësaj, mundi të siguronte edhe një sasi të hollash, që i nevojiteshin çetës gjatë udhëtimit.

Pjesëtarët e çetës ishin në gatishmëri: Sali Gjuka nga Peja, Abedin Shkëmbi nga Kolonja, Ali Fortuzi, Bedri Toptani dhe Jonuz Tafaj nga Tirana, Haki Bekteshi nga Dibra, Servet Ganaj dhe Qazim Puto nga Gjirokastra, Fadil Qani Leskoviku nga Leskoviku, Myqerem Çaçi nga Korça dhe Demir Selenica nga Vlora. Për ata, u përgatitën rroba kadifeje e ushqime dhe për dy ditë u bënë gati për udhë.

Kështu, studentët shqiptarë u nisën kryelartë e të vendosur, për ta kryer misionin e tyre atdhetar. U caktua rruga e lëvizjes: Selanik-Pire-Korfuz-Tivar. Në pikëmbërritje do t'i prisnin njerëz të Hasan Prishtinës, me të cilët kishte biseduar vetë Sali Gjuka. Për nisjen e çetës nga Selaniku i ndihmoi roja e konsullatës austriake aty, shqiptari Hasan Qinami. Ky i hipi në një vapor austriak dhe osmanët nuk mund t'u bënin gjë.

Nisja u bë afër drekës, në një ditë të bukur qershori të vitit 1912. Studentët ishin të gatshëm e të vendosur të bënin çdo sakrificë për të mirën e atdheut të robëruar, popullit kryengritës, që nga Kosova e deri në Çamëri. Kënga i shoqëroi kudo, sikur shkonin në ndonjë festë. Jehonin me zjarr fjalët e këngës: "Për Mëmëdhenë, për Mëmëdhenë,/ vraponi, burra, se s'ka me pritë!". U ndaluan në

Pire. Aty takuan dhe katër studentë të tjerë, që kishin ardhur nga Stambolli e po i prisnin. Ata ishin pikërisht Veli Harshova, Bilal Nivica, Remzi Karaliu e Rifat Gramshi.

Ndërkaq, Sali Gjuka mori me vete J. Tafajin, që dinte mirë greqisht dhe shkuan në Ministrinë e Jashtme Greke. Aty iu drejtuan një nëpunësi të lartë: "Ne jemi studentë shqiptarë të Selanikut dhe do të shkojmë në Kosovë për të luftuar kundër pushtuesve osmanë, që na kanë skllavëruar atdheun e vëllezërit tanë". Atij i kujtuan dhe fjalët e konsullit grek në Selanik, i cili kishte premtuar t'i armatoste. Por qeveritarët grekë dyshonin se mos kryengritësit e rinj do të vepronin në Jug të Shqipërisë dhe kjo gjë nuk u interesonte. Prandaj nuk u dhanë përgjigje menjëherë e prerazi. Më në fund, oficeri grek iu drejtua Sali Gjukës: "Armët e municionet jepen me kusht që çeta të shkojë drejt e në Kosovë dhe ajo të vihet nën komandën e dy oficerëve grekë".

Pasi i peshoi mirë të gjitha kushtet e rrethanat, Sali Gjuka iu përgjigj kërkesave të grekëve. Kur e morën vesh, ata u bindën dhe thanë se nuk kishte nevojë për shoqërues të tyre.

Sapo hipën në një vapor austriak, studentët luftëtarë hodhën festën e huaj, që mbanin në kokë dhe vunë kapelën. Në Pire takuan një shqiptar, i cili u tha: "Mos, djema, se kështu i shërbeni kaurit!" Por djemtë trima e kundërshtuan "shqiptarin patriot" dhe dëshmuan se ishin të vendosur në rrugën e tyre të luftës për liri e pavarësi. Ata nuk u zbrapsën përpara premtimeve dhe as kërcënimeve.

Kur ndodheshin në Pire, studentët luftëtarë me Sali Gjukën në krye, morën një telegram nga Dervish Hima, ku i njoftonte se i priste në Korfuz. Të gjithë e njihnin si trim, atdhetar e luftëtar. Ky fakt i bëri më entuziastë e të vendosur në misionin e tyre të vështirë. Rruga kaloi shpejt, me këngë luftarake e atdhetare në gojë. Në Korfuz u doli përpara atdhetari Dervish Hima. "Një figurë vigani për studentët tanë, për të cilët emri Dervish Hima ishte një legjendë". I priste ai, "trimi i Shqipës", si burra të pushkës e të vetëmohimit. Sipas propozimit të tij, qëndruan disa ditë në Korfuz dhe shkëmbyen mendime se si ta organizonin më mirë udhëtimin e punën në të ardhmen.

Dervish Hima bisedoi me Sali Gjukën dhe studentët, që t'i bindte këta të fundit të shkonin në Shqipërinë e Jugut. U

shpjegoi se aty kishte më tepër nevojë të bëhej propagandë për t'u ngritur në luftë të armatosur kundër pushtuesve otomanë, duke u bashkuar në një ideal me vëllezërit e Kosovës. Ndër të tjera, aty u tha këto fjalë: "Sidomos Gjirokastra dhe Delvina duheshin zgjuar!". Studentët pranuan njëzëri të viheshin nën komandën e D. Himës. Ky lajmëroi atdhetarët e njohur në Çamëri, Devinë e Gjirokastër, që përfaqësuesit e tyre të shkonin në Korfuz dhe së bashku të bënin planin e veprimit me çetën e studentëve. Së pari, thirri "patriotin e mirënjohur e të palodhur Nimet Abazi, nga Delvina". Ky shkoi në Korfuz dhe mori përsipër t'i printe çetës.

Por, ndërkaq, grekët e kuptuan se çeta e studentëve nuk do të shkonte direkt për në Kosovë. Prandaj prefekti i Korfuzit e thirri D. Himën dhe e porositi që t'i çonte ata në Stamboll, "ku i priste të gjithë litari"! Duhej vepruar me shpejtësi. Bënë planin dhe u arratisën me dy barka, 15 studentë me Dervish Himën e Sali Gjukën në krye. Varkat arritën në afërsi të Sarandës. Aty gjetën një udhëtregues dhe u vendosën në Karalibej. Në bashkëpunim me atdhetarët vendës, nisën propagandën e luftës kundër pushtuesve. Por nuk ishte aq e lehtë, pasi në ato krahina ndikonte edhe propaganda e vorioepirotëve. Shpejt hynë në lidhje e bashkëpunim me çetat e komitëve, të cilat vepronin në Jug të Shqipërisë.

Luftëtarët e çetës së studentëve u pritën kudo krahëhapur. Nga Manastiri i Cepos shkuan për në malin e Çajupit. Në çetë ishin 20 veta, por u hap fjala se janë ngritur me armë në dorë 500 veta, kundër pushtuesve osmanë. Pastaj kaluan në zonën e Kurveleshit, e njohur për traditat e saj luftarake. Çeta shtoej përditë me luftëtarë të rinj. Kudo ata gjetën mikpritje, përkrahje e mbështetje.

Në këtë kohë, në Turqi kishte rënë Kabineti i Ittihadit dhe me premtime erdhi në pushtet Kabineti i Gazi Muhtar Pashës. Ky ishte më i moderuar e dha premtime për çeljen e shkollave shqipe, falje të kryengritësve etj. Pra, pushonte edhe ndjekja e çetës së studentëve të Selanikut. Në këto rrethana, kështu vlerësohej se ajo e kreu misionin e saj. Por studentët dhe prijësit e tyre, Sali Gjuka e Devish Hima, kishin mendimin se çështja do të zgjidhej siç duhej dhe përfundimisht, vetëm duke i përzënë një herë e mirë pushtuesit osmanë nga vatrat amtare dhe duke fituar pavarësinë, pra armët nuk duheshin lëshuar nga dora.

Në kushtet e reja, që u krijuan, siç përshkruhet në librin e

autorit Lekë Zeza, u vendos që kjo çetë luftarake e studentëve përkohësisht të shpërndahej. Ata shkuan në Manastirin e Cepos dhe bashkë me atdhetarë të njohur nga Gjirokastra, Delvina, Kurveleshi etj., festuan suksesin e arritur deri atëherë. U mbajtën fjalime të zjarra, ku studentët i kujtonin popullit se nuk kishte rrugë tjetër, veç: "Ja vdekje, ja liri!". Studentët u shpërndanë për në vendet e tyre, me urimin e zemrës: "U takofshim me shëndet, në një Shqipëri të lirë dhe të vetëqeverisur!" Dhe vërtet ajo ditë e shumëpritur u arrit, më 28 Nëntor 1912, për të cilën dhanë ndihmesën e tyre të pakursyer këta studentë trima, bashkë me atdhetarët e shquar Sali Gjuka e Dervish Hima.